

KODI I ETIKES SE FSHF

HYRJA

Ruajtja e integritetit dhe reputacionit te futbollit shqiptar eshte qellim i perhershem i FSHF. Ne kete kuader ajo perpiqet qe te luftoje fenomene, metoda apo praktika te pamoraleshme dhe/ose jo-etike qe demtojne imazhin e institucioneve te futbollit dhe te vete lojes ne pergjithesi. Per kete qellim, Asambleja e Pergjiteshme e FSHF miraton Kodin e Etikes se FSHF (me poshte "Kodi").

I – FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Individet

1. Ky Kod aplikohet mbi te gjithe zyrtaret. Zyrtare konsiderohen te gjithe anetaret e Komitetit Ekzekutiv, arbitrat dhe asistent-arbitrat, treneret dhe te gjithe personat pergjegjes per ceshtjet teknike, mjekesore apo administrative ne FSHF, ne anetaret e FSHF dhe çdo subjekt qe merr pjese ne veprimitarite zyrtare qe organizon FSHF.
2. Nenet 2, 3, 7, 8, 13, 14 dhe Seksioni III i ketij Kodi aplikohen per analogji dhe mbi lojtaret, agjentet e lojtareve, agjentet e ndeshjeve.
3. Cdo rregullore tjeter qe ka te beje me etiken dhe sjelljen e zyrtareve, lojtareve, agjenteve te lojtareve dhe agjenteve te ndeshjeve mbetet e pandryshuar me kusht qe te mos bjere ne kundërshtim me dispozitat e ketij Kodi.

Neni 2

Koha

Ky Kod aplikohet per fakte qe kane ndodhur pasi ai ka hyre ne fuqi. Ai gjithashtu mund teaplikohet per fakte qe kane ndodhur me pare ne rastet kur eshte me i favorshem per shkelesin me kusht qe vendimi i Komisionit te Etikes ne FSHF do merret pas hyrjes ne fuqi te Kodit.

II. RREGULLAT E SJELLJES

Neni 3

Rregulla te pergjitheshme

1. Zyrtaret duhet tenjohin detyrate tyre dhe obligimet e pergjegjesite qe rrjedhin nga ato. Sjellja e tyre duhet teshprehe mbeshtetjen qe ata i japin FSHF-se dhe anetareve, perpjekjen per shmangien me te gjitha menyrat te te çdo situatë qe mund te demtoje ato qellimet dhe objektivat e tyre. Ata duhet te jene besnike te FSHF dhe anetaret e saj duke i perfaqesuar ata me ndersheri, dinjitet, respekt dhe integritet.
2. Zyrtaret duhet tedemostrojne angazhimin e tyre per nje qendrim ne perputhje me etiken gjate tere veprimitarise ne kryerje te detyrave. Ata duhet te angazhohen se do sillen ne menyre dinjitoze. Sjellja dhe veprimet e tyre duhet te jene te besueshme dhe me integritet te plote.
3. Zyrtaret ne asnje rast nuk duhet te abuzojne me pozicionin qe u jep kryerja e detyrave vecanerisht duke e shfrytezuar ate per perfitime private.

Neni 4

Pranimi dhe largimi

1. Pranohen te sherbejne si zyrtare vetem personat qe zoterojne nivel te larte etike dhe integriteti dhe qe angazhohen te respektojne pa rezerva dispozitat e ketij Kodi.
2. Nuk pranohen tesherbejne si zyrtare personat qe jane denuar per krime qe vene ne dyshim aftesine e tyre per kryerjen e detyrave.
3. Zyrtaret qe shkelin dispozitat e ketij kodi, qe nuk arrijne te permbushin kerkesat e tij ose qe nuk veprojne ne menyren e duhur, vecanerisht ne trajtimin e ceshtjeve financiare, behen te papranueshem dhe duhet te largohen nga detyra.

Neni 5

Konflikti i interesave

1. Perpara zgjedhjes apo emerimit ne nje detyre zyrtaret duhet te deklarojne te gjitha interesat personale qe kane ose mund te kene lidhje me funksionet e tyre te ardheshme.
2. Ne procesinn e kryerjesse detyrave, zyrtaret duhet te shmangin cdo situat qe çon ose mund te çojne ne konflikte interesash. Perben konflikt interesash rasti kur zyrtaret kane ose dyshohet te kene interesa private dhe/ose personale qe cenojne aftesine e tyre per te kryer detyren me integritet, ne menyre te pavarur dhe me vendosmeri. Ne interesat private dhe/ose personale perfshihetdhe perfitimi i favoreve per veten, familjen, te afermit, miqte dhe partneret.
3. Nje zyrtar duhet te nderprese kryejn e detyrave te tij ne rastin keto krijojne nje konflikti interesash apo nje mundesi per konflikt interesash. Ne kete rast informohet menjehere institucioni ne kuader te te cilit zyrtari konkret ushtron detyrat.
4. Ne rastet kur i behet e ditur mbi ndonje konflikt interesi egzistues ose te mundshem qe lidhet me kryerjen e detyrave te tij, zyrtari ja bene kete menjehere te ditur institucionit ne kuader te te cilit zyrtari ushtron detyren konkrete.
5. Vetem autoriteti vendim-marres i institucionit perkates mund tevendose ne lidhje me konfliktin e interesave qe raportohet dhe menyren e trajtimit te tij.

Neni 6

Sjellja me institucionet qeveritare dhe ato private

Ne marrdheniet me institucionet qeveritare, organizatat nderkombetare, shoqatat e grupimet ndryshme, pervec kerkesave te nenit 3, zyrtaret duhet te qendrojne politikisht neutral dhe mbajne qendrim ne perputhje me objektivat e FSHF dhe anetareve te saj. Sjellja e tyre duhet te jete me integritet dhe kompatibel me detyrat qe ata kane.

Neni 7

Diskriminimi

Zyrtaret nuk duhet te cenojne dinjitetin e nje personi dhe/ose grupi personash nepermjet veprimeve apo fjaleve percmuese, diskriminuese dhe/ose denigruese per etnine, racen, ngjyren, kulturen, gjuhen, fene apo gjinine.

Neni 8

Mbrojtja e te drejtave individuale

Zyrtaret duhet te sigurojne qe gjate ushtrimit te detyres se tyre te mbrojne, respektojne dhe garantojne te drejtat individuale te personave me te cilat hyjne ne marrdhenie dhe nderveprojne.

Neni 9

Besnikeria dhe konfidencialiteti

1. Zyrtaret duhte te njohin detyrimin per besnikeri ndaj FSHF dhe anetareve te saj.

2. Çdo informacion qe i vihet qe zyrtaret posedojne ne funksion te zbatimit te detyrave te tyre do te ruhet si konfidencial ose secret. Informacionet ose opinionet nxirret ne perputhje me parimet, direktivat dhe objektivat e FSHF-se dhe anetareve te saj.

Neni 10

Pranimi i dhuratave dhe perfitimeve te tjera.

1. Zyrtareve nuk u lejohet te pranojne dhurata dhe perfitime te tjera qe kane vlereme te madhe se ajo qe percaktohet per kete qellim nga institucioni ne kuader te te cilit ai kryen detyren konkrete. Ne rastet kur zyrtari ka dyshim mbi vleren e dhurates ajo nuk duhet tepranohet. Marrja e dhuratave ne te holla eshte e ndaluar per cdo lloj shume.
2. Ne permbushje te detyrave te tyre, zyrtaret mund te japin dhurata ose perfitime te tjera vlera e te cilave nuk e kalon kufirin qe institucioni ka percaktuar per kete qellim me kusht qe dhurata ose perfitimi i dhene te mos sjelle avantazh te pandershem dhe te mos perbeje konflikt interesash.
3. Zyrtaret nuk duhet temarrin anetarete familjes apo partnere te bineseve personale ne eventet zyrtare ku shpenzimet jane te FSHF ose anetareve te saj me perjashtim te rasteve kur nje gje e tille eshte lejuar nga institucioni perkates.

Neni 11

Rryshfeti

1. Zyrtaret nuk duhet te pranojne rryshfet ose me fjale te tjera ata duhet te refuzojne dhurata ose avantazhe qe ofrohen, premtohen ose ju dergohen me qellim qe te kryhen shkelje te detyrave ose sjellje te pandershem ne perfitim te nje pale te trete.
2. Zyrtaret e kane te ndaluar te japin rryshfet paleve te treta me qellim qe te perfitojne avantazhe per vetvehte ose pale te treat. Po keshtu, zyrtaret e kane te ndaluar te nxisit apo shtyjne te tjere per te bere nje gje te tille.

Neni 12

Komisionet

Zyrtareve ju ndalohet qe ne kryerje te detyrave te tyre te pranojne komisione ose premtime komisionesh per te negociuar marrveshje te cdo lloji qofshin, me perjashtim te rasteve kur organi drejtues i institucionit e ka bere te qarte se e lejon nje gje te tille. Me mungese te nje organi drejtues, kete vendim e merr organi te cilit i perket zyrtari.

Neni 13

Bastet dhe manipulimi i rezultatit te ndeshjeve

1. Zyrtareve ju ndalohet qe te marrin pjese, direkt ose indirekt, ne baste, bixhoz, llotari apo veprimtari te ngjashme qe lidhen me ndeshje futbollit ne kategorite futbollistike ku ata marrin pjese . Ata ndalohet te marrin pjese aktivisht ose pasivisht ne kompani, bashkim kompanish, organizata, etj qe nxisin, ndermjetesojne, organizojne ose kryejne veprimtari te tilla.
2. Zyrtareve ju ndalohet te marrin pjese direkt ose indirekt ne perpjekje per paracaktimin apo manipulimin e rezultatit te nje ndeshje futbollit ose te nje pjese te caktuar te saj.

Neni 14

Detyrimi per deklarim dhe raportim

1. Zyrtaret duhet te raportojne cdo shfaqje te shkeljeve te sjelljes te Sekretari i Pergjithshem i FSHF-se i cili ipercjell ato per vendim nga organi kompetent.
2. Personat e implikuar detyrohen te japin cdo informacion qe kerkon organi kompetent vecanerisht me lidhje me te ardhuratsi dhe te paraqesin evidencat perkatese.

Neni 15

Komisionit te Etikes dhe Juridiksioni

1. Struktura dhe objekti i Komisionit te Etikes percaktohet ne Statutin e FSHF. Ai gjykon cdo ceshtje qe eshte ne juridiksionin e FSHF.
2. FSHF ka juridiksion mbi sjelljen e zyrtareve te FSHF dhe zyrtareve te anetareve te saj.
3. FSHF ka juridiksion mbi sjelljen e lojtareve, agjenteve te lojtareve, agjenteve te ndeshjeve ne rastet kur shkelja qe gjykohet prek FSHF dhe anetaret e tjere te saj.
4. FSHF ka juridiksion mbi ceshtjete subjekteve qe marrin pjese ne veprimtarite e organizuara nga ajo ne rastin kur ato ose organizatat sportive ku ato bejne pjese nuk bejne te mundur ndjekjen dhe gjykimin e ketyre shkeljeve ose nuk kryejne paditjen e tyre ne perputhje me parimet e ligjit.

Neni 16

Pranimi i kerkesave

Kushdo qe ka informacione qe mund te perbejne ceshtje per gjykim nga Komisioni i Etikes se FSHF mund t'i paraqese ato ne FSHF. Sekretari i Pergjithshem i FSHF garanton qe cdo informacion t'i paraqitet Komisionit te Etikes.

III. RREGULLAT

Neni 17

Zbatimi i Kodit te Disiplines Sportive te FSHF

1. Komisioni i Etikes ka te drejte te jape cdo mase qe parashikohet ne Statutin e FSHF dhe ne Kodin e Disiplines Sportive te FSHF.
2. Rregullat organizative dhe procedurale te Komisionit i Etikes jane ato qe parashikohen ne Kodin e Disiplines Sportive te FSHF me perjashtim te rasteve kur jane rregulluar ndryshe ne kete Kod ose kur dispozitat e Kodit te Disiplines Sportive te FSHF nuk mund te gjejne aplikim per shkak te objektivave dhe permbajtjes se ketij Kodi.

Neni 18

Apeli

1. Vendimet e Komisionit te Etikes mund te depozitohen per apel ne Komisionin e Apelit te FIFA me perjashtim te rasteve kur vendimi i dhene eshte: Vendimet e dhena nga Komisioni i Apelite FIFA qe nuk depozitohen ne Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS) jane perfundimtare.
 1. paralajmerim
 2. qortim
 3. pezullim per me pak se tre ndeshje ose deri ne dy muaj
 4. gjobe me pak se 200,000 leke

Neni 19

Perplasja e kompetencave

Çeshtjet qe janenjekohehsisht ne fushen e veprimit te ketij Kodi poredhe te Kodit te Disipilines si rregull do te trajtohen nga Komisioni i Etikes. Ne marrveshje midis tyre, kryetaret e ketyre komisioneve mund te vendosin ndryshe.

IV. DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 20

Gjuha zyrtare

Ky Kod miratohet ne gjuhen shqipe. Per qellime praktike FSHF mund te vendose te botoje dhe ta shperndaje ate ne gjuhe te tjera.

Ne rast mosperputhje midis teksteve, perparesi ka versioni shqip.

Neni 21

Miratimi dhe hyrja ne fuqi

Asambleja e Pergjitheshme e FSHF e miratoi kete Kod ne daten 22 Shkurt 2012.

Ky Kod hyn ne fuqi ne daten 1 Mars 2012